



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

2023/0125

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së OE ALBKOS SAFETY SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pushkë impulsive për nevojat e Drejtorisë së DSHM-së” me numër të prokurimit 651-23-801-1-3-6, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, më 04/04/2023, mori këtë:

VENDIM

- 1. Aprovohet pajtimi i palëve**, për ankesën e "Albakos Safety" me nr. 2023/0125 , e datës 09/03/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pushkë impulsive për nevojat e Drejtorisë së DSHM-së”, me numër të prokurimit 651-23-801-1-3-6, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.
- 2. Obligohet**, AK – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN që aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pushkë impulsive për nevojat e Drejtrisë së DSHM-së”, me numër të prokurimit 651-23-801-1-3-6, konform raportit të ekspertit shqyrtues me të cilin AK është pajtuar, ti bëjë ndryshimet e nevojshme në Dosje të Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë si dhe të zgjasë afatin për ofertim.
3. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informojë me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në harmoni me paragrafët specifik të dispozitivit të këtij Vendimi;
4. Në rast të mosrespektimit të këtij Vendimi, Paneli Shqyrtues ka të drejtë që të ndërmarrë masa sikurse parashihen ato në nenin 131 të Ligjit për Prokurim Publik të nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092;
5. Me qenë se OE ankues është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues ku ankesa aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
6. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës

ARSYETIM

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.02.2023, AK- KK Gjilan, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë (dosja e tenderit) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pushkë impulsive për nevojat e Drejtorisë së DSHM-se" me nr. të prokurimit: "651-23-801-1-3-6". Dosja e tenderit, dt. 10. 02. 2023 (e korigjuar më 14.02.2023 dhe më 15.02.2023).

OE Albkos Safety, me datën 21.02.2023 ka parashtruar Kërkesën për rishqyrtim, ndërsa Vendimi i AK mbi Kërkesën për rishqyrtim, është bërë me dt. 28.02.2023.

B58 Njoftim mbi vendimin e AK, dt. 28.02.2023, ndërsa me datën 09. 03. 2023 është publikuar Njoftimi B10 Vendim për Anulimin e Aktivitetit.

I pakënaqur me vendimin e AK-së në kërkesën për rishqyrtim, OE "Albkos Safety" me datën 09.03.2023, ka parashtruar ankesë në OSHP me numër protokolli 125/23.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bijnë nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 20. 03. 2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në konstatimet e lartpërmendura në ekspertizë, eksperti shqyrtues vlerëson se AK-KK Gjilan nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, prandaj i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Albkos Safety" Sh.p.k., të aprovohet pjesërisht, të anulohet njoftimi për anulim të tenderit, dhe të bëhen përmirësime në dosje të tenderit, respektivisht te specifikimet teknike të detyrueshme, përderisa eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114, pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me nr. prokurimi 651-23-801-1-3-6, në përputhje me kriteret e parapara.

Palët janë njoftuar me raportin e ekspertit të jashtëm shqyrtues përmes sistemit të e-prokurimit.

1. Autoriteti kontraktues – Komuna e Gjilanit, me datën 22 mars 2023, përmes sistemit të e-prokurimit ka deklaruar se pajtohen me mendimin e ekspertit të jashtëm shqyrtues të OSHP-së.
2. Operatori ekonomik ankues "Albkos Safety SH.P.K", përmes sistemit të e-prokurimit me datën 21 mars 2023 kanë deklaruar se pajtohen me mendimin e ekspertit të jashtëm shqyrtues të OSHP-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklarimeve të palëve se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues për anulim të aktivitetit të prokurimit, andaj konform nenit 19 paragrafi 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar) paneli shqyrtues deklaron se procedura e shqyrtimit të ankesës përfundon në këtë fazë, ndërkaq obligohet Autoriteti Kontraktues, që të anuloj njoftimin për anulim dhe të bëhen përmirësime në dosje të tenderit, respektivisht te specifikimet teknike të detyrueshme, sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, dhe brenda afatit 5 ditor konform LPP-së ta njoftoj panelin shqyrtues me veprimet e ndërmarra

Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

1x1 OE - **ALBKOS SAFETY SH.P.K.**

1 x 1 Arkivës së OSHP-së:

1 x 1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së

